

Parlamenti miraton ndryshimet në Ligjin për Diasporën



Parlamenti ka votuar pro ndryshimeve në Ligjin për Diasporën, ndryshime të propozuara pas krijimit të dy strukturave të reja për Diasporën, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Komiteti Shtetëror për Diasporën. Me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko ndryshimet në ligjin për Diasporën ligji i ndryshuar për Diasporën parashikon dhënien e bursave studentëve nga komunitetet shqiptare të Diasporës për të studiuar në universitetet e Republikës së Shqipërisë gjithashtu ligji për Diasporën përfshin dhe dhënien e çmimeve kombëtare dhe medaljeve për kontribut të veçantë në ruajtjen, forcimin e lidhjeve ndërmjet vendit të origjinës dhe Diasporës, promovimin e Shqipërisë në botë dhe përkrahjen e interesave të saj.

Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

Qendra e Botimeve për Diasporën, takim bashkëpunimi për mësimdhënien në Diasporë



Qendra e Botimeve për Diasporën priti Konsullin e Përgjithshëm të Kosovës në Shqipëri z. Halim Krasniqi, Ministrin Këshilltar pranë Ambasadës së Republikës së Kosovës në Tiranë z. Haxhi Bajraktari, drejtoreshën e Drejtorisë së Diplomacisë Publike dhe Diasporës znj. Mira Hoxha dhe drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme znj. Etleva Haka, përfaqësuese të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, nën kujdesin e drejtoreshës së Qendrës së Botimeve për Diasporën znj. Mimoza Hysa dhe përfaqësuesve të stafit të QBD-së. Tema e diskutimit të këtij takimi ishte bashkëpunimi i punës mes institucioneve të Shqipërisë dhe Kosovës lidhur me mësimdhënien në Diasporë, si dhe vijueshmëria e punës së Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, me qëllim arritjen e produkteve të përbashkëta dhe cilësore në shërbim të shqiptarëve në mërgatë. Komisioni i Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën është ngritur në zbatim të marrëveshjes së miratuar midis dy shteteve "Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe mërgatë", dhe së shpejti do të mbledhet për takimin e radhës në Tiranë.

"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës"



"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës" është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

QSPA publikon revistën informuese



Qendra e Studimeve dhe e Publikimeve për Arbëreshët ka publikuar këto ditë revistën informuese. Në këtë revistë shpalosen disa aspekte të punës dhe organizimit të QSPA, duke filluar me paraqitjen e bazës ligjore të ndërtimit dhe funksionimit të saj. Më tej prezantohen misioni dhe detyrat e qendrës si dhe prezantimi i anëtarëve të Këshillit Koordinues të saj, si dhe Këshilli Akademik Teknik mbi botimet. Në pjesën vijuese, lexuesit e interesuar mund të lexojnë mbi strukturën organizative të qendrës dhe më tej janë paraqitur objektivat e punës, memorandumet dhe marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara deri më tani.

REVISTË INFORMUESE

QENDRA E STUDIMEVE DHE E PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT

Drejtoresha ekzekutive e QSPA-së takim me znj. Ornela Radovicka

Në mjediset e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), u krye takimi me znj. Ornela Radovicka, e cila solli një sasi librash të studiuesit arbëresh Papas Antonio Bellusci, bashkëpunëtorë e të cilit është prej shumë kohësh. Këto libra u dhuruan me dedikimin e vetë zotit Bellusci. Zonja Radovicka u prit nga Drejtoresha Ekzekutive e QSPA, Prof. Diana Kastrati dhe stafi i qendrës, që i përcollën mirënjohjen dhe nderimin ndaj figurës dhe kontributit të Papas Bellusci për punën e palodhur të tij dhe përkushtimin ndaj dokumentimit të trashëgiminë e larmishme kulturore të arbëreshëve



KKD / Lazim Destani me Konsullin e Kosovës: Mundësi bashkëpunimi për investime



Biznesmeni dhe filantropi Lazim Destani zhvilloi një takim në Dyseldorf me Konsullin e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, z. Arjan Kashtanajeva ku diskutuan mbi tematika të ndryshme të zhvillimeve në Kosovë dhe mundësinë e bashkëpunimit për investime. Në një postim në facebook Presidenti i Nderit të Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare shkruan se ndër të tjera e ka informuar konsullin edhe për aktivitetet e Këshillit Koordinues të Diasporës si dhe të Dhomës së Biznesit të Diasporës.

KKD / Mark Gjonaj dhuron maska falas në New York

Mark Gjonaj, kryetar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht këshilltar i Bashkisë së Nju Jork-ut, së bashku me disa organizata humanitare dhe vullnetarë vijnë me shpërndarjen e maskave për qytetarët në New York.



Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për here të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS



App store [këtu](#); Play store [këtu](#);

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#);